

VENDIM
Nr.1642, datë 17.12.2008

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM,
TË BASHKISË PËRRENJAS TË QARKUT TË ELBASANIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Përrenjas të qarkut të Elbasanit, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të kësaj bashkie, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 113 (njëqind e trembëdhjetë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 870 (tetëqind e shtatëdhjetë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Përrenjas për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Përrenjas		Lidhja nr.1
Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-3	Prona që përdoren në fushën administrative.	Në pronësi
4-7,9-16,346	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
20,21,22,24	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
25-27,29-31	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
32-41	Varrezat publike.	Në pronësi
60-213,361-373,377,379-383	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji.	Në përdorim
317-345,374-376,385-444,825,826,493-495	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike).	Në pronësi
57-59	Prona që përdoren në fushën e shërbimit social.	Në pronësi
42-56	Prona që përdoren në fushën e	Në pronësi

	strehimit dhe të mbrojtjes civile.	
534,535,537,538-556,565-824	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
516-522,536,539,557-564	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe joproduktive).	Në pronësi
384	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ndriçimit publik.	Në pronësi
314-316	Prona që përdoren në fushën e ujësjellës-kanalizimeve.	Në pronësi
869	Prona që përdoren në fushën e zhvillimit ekonomik (prona shtesë).	Në pronësi